



Prishtinë: 23.06.2016
Kodi i ZRRE-së: V_830_2016

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Dëshmitë e paraqitura nga palët;
- Rekomandimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_R_1497_06_16**;

në seancën e mbajtur më datë 23.06.2016, nxori këtë:

V E N D I M

I **APROVOHET** ankesa e konsumatorit R. C. nga Vitia e Marecit si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.

Arsyetim

Pranë Zyrës së Rregullatorit për Energji me datë 14.03.2016 është parashtruar ankesa nga konsumatori R. C. nga Vitia e Marecit lidhur me kthimin e rrjetit elektrik në gjendjen e mëparshme si dhënien e lidhjes së re nga ana e KEDS dhe KESCO

Nga të dhënat vërtetohet se me datë 06.12.2013 Divizioni i Shpërndarjes bazuar në ankesën/kërkesën e konsumatorit i ka lëshuar një njoftim konsumatorit R. C. me adresë në Viti e Marecit, në të cilin njoftim KEDS ka theksuar se bazuar në kërkesën e konsumatorit R. C. që ka të bëjë me zgjerimin e rrjetit 0.4 kV ipet zgjidhja teknike të cilën e kanë dhe skica e rrjetit elektrik të cilën konsumatori duhet ta ndërtoj për tu kyçur në rrjetin elektrik, si dhe i kanë theksuar se para fillimit të punimeve investitori është i obliguar të sjell në Divizionin e Shpërndarjes regjistrin e punëtorëve për ekzekutimin e punëve dhe emrin e organizatës së licencuar nga Ministria e Tregtisë së Industris (MTI) bashkë me numrin e regjistrit të automjeteve për kryerjen e punimeve. Në zgjidhjen teknike të dhënë konsumatorit R. C. KEDS ka theksuar se në këtë pjesë të rrjetit të rrjetit elektrik duhet të ndërrohen disa shtylla, pasi shtyllat tjera janë ekzistuese, si dhe furnizimi të merret nga rrjeti ekzistues.

Provë: Njoftimi i KEDS-it – Divizioni i Shpërndarjes nr.8854 i datës 06.12.2013

Prapë me datë 02.07.2015 Divizioni i Shpërndarjes bazuar në ankesën/kërkesën e konsumatorit i ka lëshuar Zgjidhjen Teknike konsumatorit R. C. me adresë në Viti e Marecit. Në këtë zgjidhje teknike të KEDS-it është theksuar se lidhur me kërkesën e konsumatorit R. C. e që ka të bëjë me zgjerimin e rrjetit 0.4 kV KEDS-i jep zgjidhjen teknike të paraqitur në skicën e bashkangjitur, si dhe i kanë theksuar se para fillimit të punimeve investitori është i obliguar të sjell në Divizionin e Shpërndarjes regjistrin e punëtorëve për ekzekutimin e punëve dhe emrin e organizatës së licencuar nga Ministria e Tregtisë së Industris (MTI) bashkë me numrin e regjistrit të automjeteve për kryerjen e punimeve.

Provë: Zgjidhja Teknike e KEDS-it – Divizioni i Shpërndarjes nr.5288i datës 02.07.2015



I paknaqur me këtë zgjidhje teknike konsumatori ka parashtruar ankesë në ZRRE duke kundërshtuar zgjidhjen teknike të lëshuar nga KEDS-i pasi sipas konsumatorit ai ka kërkuar lidhje të re, ndërsa KEDS-i po i jep zgjidhje teknike që konsumatori të bëjë investimin e rrjetit elektrik dhe pastaj të bëhet lidhje e re. Konsumatori në ankesën e tij ka theksuar se rrjeti elektrik të cilën e kanë dhënë KEDS-i në zgjidhjen teknike gjithmonë ka ekzistuar dhe se ato asete janë të KEDS-it dhe jo të konsumatorit. Gjithashtu konsumatori në ankesën e tij ka theksuar se është i pajtimit që prej shtyllës së fundit e deri te pika matëse të bëjë investimin e nevojshëm, por jo të tërë rrjetit elektrik të KEDS-it sipas zgjidhjes teknike.

Lidhur me ankesën e konsumatorit, ZRRE ka shkëmbyer disa korrespondenca (data 14.03.2016, 24.03.2016 dhe 06.04.2016) me KEDS-in duke i kërkuar sqarime me shkrim se pse duhet konsumatori të vendos përçues në pjesën ku ekziston rrjeti i KEDS-it dhe pse të ndërrohen shtylla nga ana e konsumatorit kur shtyllat elektrike janë pronë (aset) i KEDS-it. KEDS-i është përgjigjur shkresave të ZRRE-së në datat 16.03.2016 dhe 12.04.2016 duke theksuar se refuzon t'i ofrojë konsumatorit lidhje të re duke e kushtëzuar konsumatorin që të bëjë investimin në atë pjesë. Gjithashtu KEDS në korrespondencë me ZRRE-në ka potencuar se ajo linjë nuk është në planin zhvillimor/investiv të paraparë, si dhe ajo linjë nuk është aset i KEDS-it

ZRRE ka analizuar dokumentin e KEDS-it – Zgjidhje Teknike nr.5288 i datës 02.07.2015 dhe se sipas dokumentit në fjalë është vërejtur se mes tjerash nga vet punëtorët e autorizuar të KEDS-it të cilët kanë dalur te konsumatori (vendi i ngjarjes) për të bërë analizimin e situatës energjetike është konstatuar se shtyllat janë ekzistuese, por pa përçues, pasi që përçuesit janë vjedhur, si dhe tash kanë mbetur vetëm shtyllat. Pra, nga ky dokument vet punëtorëve të KEDS-it kanë konstatuar se ekziston rrjeti i KEDS-it në atë vend, por që nuk ka përçues në atë pjesë të rrjetit, për arsye se është vjedhur.

Sa i përket konstatimit apo arsyetimit të KEDS-it që kjo linjë nuk është paraparë të planin zhvillimor/investiv të KEDS-it, duhet theksuar se konsumatori qysh në vitin 2013 ka parashtruar kërkesë për lidhje të re, dhe se KEDS-i ka mundur që nga atëherë të bëjë përpjekje që këtë linjë të paraqes në planet e tyre zhvillimore/investive në ZRRE për aprovim, dhe t'i ofrojë konsumatorëve të asaj pjese furnizim me energji elektrike pasi që sipas nenit 26 të Ligjit për Energjinë Elektrike, çdo konsumator shtëpiak ka të drejtën që të furnizohet me energji elektrike të një cilësie të specifikuar me çmime të arsyeshme, transparente dhe që mund të krahasohen në mënyrë të lehtë dhe të qartë. Sipas Rregullës për Çmime të OSSH-së, shtojca 2 – Baza e Aseteve të Rregulluara, paragrafi 7, pika 7.3 theksohet se: *“OSSH mund të aplikojë në çdo kohë te rregullatori për të zëvendësuar një projekt kapital në planin e aprovuar të investimit me ndonjë projekt tjetër kapital në rastet kur mund të dëshmohet se projekti alternativ do të sjellë përfitime të njëjta apo më të mira për konsumatorët se projekti fillestar (duke marrë parasysh rezultatet e pritura dhe kostot). Nëse rregullatori e aprovon zëvendësimin, projekti alternativ do t'i shtohet bazës së aseteve të rregulluara në shqyrtimin periodik të ardhshëm”*.

Konstatimi i KEDS-it se kjo linjë nuk është aset i KEDS-it nuk qëndron pasi që me procesin e privatizimit e cila ka ndodhur me datë 08.05.2013, të gjitha asetet të cilat kanë qenë pjesë e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes - KEK-ut kanë kaluar te KEDS-i dhe sipas kësaj mund të konstatohet se pronar i këtyre aseteve është KEDS-i e jo konsumatorët, dhe se për investimet në rrjetin elektrik që përfshin edhe këtë kategori të investimeve përgjegjës është KEDS-i dhe jo konsumatorët. Sipas Rregullës për çmime të OSSH, të gjitha asetet ekzistuese janë të përfshira në bazën e aseteve të rregulluara dhe për këto ZRRE gjatë procesit tarifor në tarifa lejon kosto në mirëmbajtjes së këtyre aseteve, pra konsumatorët paguajnë për zëvendësimin (pas amortizimit/zhvlerësimit) dhe mirëmbajtje të këtyre aseteve, si dhe vetëm shitjet e aseteve gjatë



periudhës rregullative do të zbriten nga baza e aseteve të rregulluara bazuar në vlerën e shitjes së tyre.

Lidhur me këtë ZRRE, konstaton se pavarësisht se në çfarëdo gjendje janë trashëguar stabilimentet energjetike ekzistuese KEDS-i e ka obligim ligjor që të bëjë mirëmbajtjen e këtyre stabilimenteve në atë mënyrë që t'i sigurojë konsumatorit furnizim me energji elektrike në përputhje me ligjet dhe rregullat në fuqi. Për më tepër neni 23 i Ligjit për energjinë përcakton se: *“Të gjitha stabilimentet e reja dhe ekzistuese për prodhimin, transmisionin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike, ngrohjes ose gazit natyror do të jenë në prona për të cilat ndërmarrja përkatëse e energjisë gëzon të drejtat përkatëse të pronësisë, shfrytëzimit ose qasjes”.*

Në nenin 26 të Ligjit për Energjinë Elektrike, thuhet se: *“Në përputhje me paragrafin 1. të nenit 23 të këtij ligji, çdo konsumator shtëpiak ka të drejtën që të furnizohet me energji elektrike të një cilësie të specifikuar me çmime të arsyeshme, transparente dhe që mund të krahasohen në mënyrë të lehtë dhe të qartë”.* Në bazë të dispozitave ligjore të përcaktuara në Ligjin për Energjinë Elektrike, përkatësisht neni 28 të këtij ligji, theksohet se Operatori i Sistemit të Shpërndarjes duhet të lidh/kyç çdo konsumator, natyrisht i cili i plotëson të gjitha kushtet teknike të parapara në kodet teknike. Sipas nenit 29, paragrafi 1, theksohet se: *“Konsumatorët ose prodhuesit e përmendur në nenin 27 të këtij ligji nuk kanë të drejtë të kyçen në sistem, nëse nuk i kanë plotësuar kriteret për kyçje, apo nëse kyçja do të shkaktonte çrregullime të mëdha në furnizim”,* si dhe në paragrafin 2 të këtij neni theksohet se: *“Operatori i Sistemit të Transmisionit apo Operatori i Sistemit të Shpërndarjes mund ta refuzojë përkohësisht kyçjen e një konsumatori ose prodhuesi në sistem, nëse konstaton se pajisjet e konsumatorit apo të prodhuesit dështon në plotësimin e normave teknike ose kushtet tjera të përshkruara në kodet teknike. Konsumatori ose prodhuesi duhet të informohet me shkrim për arsyet e çdo refuzimi të tillë”.* Gjithastu edhe në nenin 10 të Rregullës për Kushtet e përgjithshme të Furnizimit me Energji, theksohet se OSSH mund të refuzojë kyçjen e një aplikuesi përkohësisht ose përherë, vetëm nëse ajo kyçje nuk është e mundshme teknikisht ose ekonomikisht apo nuk është në përputhje me dispozitat e Kodit të Rrjetit dhe Shpërndarjes ose kodet e tjera në fuqi, por që refuzimi të ipet me shkrim brenda afatit 30 ditor prej datës së dërgimit të aplikacionit, si dhe Operatori i Sistemit në njoftimin e refuzimit duhet t'i referohet mundësisë së kyçjes në të ardhmen në përputhje me Planin zhvillimor. Në rastin në fjalë KEDS-si ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore të të përcaktuara Ligjin për Energjinë Elektrike të cekur më lartë, si dhe me dispozitat e Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji, pasi që asnjëherë nuk i ka kthyer konsumatorit me shkrim arsyet e refuzimit të kyçjes së konsumatorit, por vetëm i ka dhënë zgjidhjen teknike konsumatorit.

DMK për të analizuar sa më saktë lëndën e konsumatorit dhe gjendjen e rrjetit elektrik të asaj pjese, me datë 20.05.2016 kanë dalur te konsumatori dhe kanë bërë inqizimin dhe fotografimin e rrjetit ekzistues. Nga vizita në teren është konstatuar se shtyllat elektrike ekzistojnë, përveç disa shtyllave të cilat ose janë të rrëzuara ose nuk ekzistojnë fare. Nga vizita në teren është konstatuar se në këto shtylla (pjesë të rrjetit elektrik) nuk ka përçues i cili kalon nëpër shtylla dhe se këtë konstatim e kanë dhënë edhe vet punëtorë e KEDS-it dhe banorët e asaj pjese. Sipas konstatimeve të punëtorëve të KEDS-it dhe banorëve të asaj pjese përçuesi është vjedhur dhe tani kanë mbetur vetëm shtyllat elektrike. Sipas ankesës së konsumatorit dhe banorëve të asaj pjese, ai rrjet elektrik ka ekzistuar më herët, por që për arsye të ndryshme dikush ka vjedhur përçuesin elektrik i cili kalon nëpër ato shtylla elektrike. Konsumatori në fjalë i ka siguruar ZRRE edhe disa shifra të konsumatorëve të asaj pjese për të vërtetuar se aty ka pasur më herët rrjet elektrik dhe konsumatorët kanë pasur më herët shifra të konsumatorëve, por që pasi që një periudhë nuk kanë jetuar në atë pjesë shifrat e konsumatorëve janë pasivizuar (shifrat e konsumatorëve të cilat i ka siguruar konsumatori janë: DPR – 62654, DPR – 62638, DPR – 62582, DPR - 62636 etj). Po ashtu vlen të theksohet se gjatë analizës së bërë këtyre



transaksioneve të konsumatorit vërehet se këo shifra janë faturuar deri në muajin 11/2009, kryesisht faturim ka qenë vetëm me taksa dhe me vlera paushalle. Pasivizimi i këtyre shifrave nga ana e KEK-ut është bërë pas faturës së muajit 11/2009.

Provë: Fotografitë dhe inqizimi i gjendjes së rrjetit elektrike nga DMK dhe transaksionet e konsumatorit

Nga krejt ajo që u theksua më lartë edhe përkundër faktit se iniciues i ankesës ka qenë konsumatori i lartshënuar, nga vizita në teren kemi vërejtur se ka edhe konsumator të tjerë që kanë shprehur interesim që të i rikthehet rrjeti elektrik si në gjendjen e mëparshme ashtu që të mund të parashtrajnë kërkesat e tyre për lidhje të re gjë për të cilat DMK ka marr edhe disa fotografi si dëshmi për nevojat e tyre për lidhje të re.

Pas analizimit të të gjitha dëshmive të prezantuara nga palët në kontest dhe Rekomandimin e paraqitur nga DMK, Bordi i ZRRE-së në mbeldhjen e mbajtur me datë 23.06.2016, vendosi që të **aprovoj** ankesën e konsumatorit si të bazuar dhe të obligon KESCO dhe KEDS-in që:

1. Të investojnë në pjesën e rrjetit elektrik ku konsumatorit R.. C.. i ka dhënë zgjidhjen teknike, respektivisht bazuar në kërkesën e konsumatorit, brenda afatit prej 2 muaj.
 2. Pasi t'i përmbushen të gjitha kushtet teknike për lidhje të re, t'i ofrohet konsumatorit lidhje e re.
- III.** Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Enver Halimi, kryesues

Krenar Bujupi, anëtar

Arsim Janova, anëtar

Qemajl Mustafa, anëtar

Besim Sejfiqaj, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Konsumatorit R. C,
- KESCO-s, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.